



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec  
Prishtina-Skupština/Rahovec/Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 92 Nr. ifaq/Br.str./No.p 01/23

Data/Datum/Date 27.06.2023

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.06.2023, miraton këtë:

**V E N D I M**

**Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510063-01031-0 në Zonën Kadastrale Polluzhë**

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/728/23 i datës 8.6.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510063-01031-0 në Zonën Kadastrale Polluzhë, në sipërfaqe prej 600m<sup>2</sup> (gjashtëqind metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10756m<sup>2</sup> (dhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë metra katror) në vendin e quajtur sello, me kulturë kullosë e klsasës 3, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.SH.E KOSOV. K.K. RAHOVEC- SHFRY.EKO. E PYJE.RAHOVEC.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror".
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01Nr.92/23  
Datë:27.06.2023

